

Integrimi i veriut të Kosovës

Hyrje

Paqaartësia mbretëron në veri të Kosovës ne kohën kur Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar kanë filluar implementimin e marrëveshjes për integrimin e këtij rajoni në sistemin e Kosovës. Shumë serbë në veri ende mbeten kundërshtues ndaj integrimit dhe thonë se janë të befasuar nga pajtimi i Beogradit për shpërbërjen e institucioneve serbe dhe integrimin e tyre në një shtet të cilin ai vetë nuk e pranon. Përfaqësuesit e katër komunave paralele në veri e kundërshtojnë marrëveshjen dhe refuzojnë të marrin pjesë në zbatimin e saj.¹ Për më shumë, ata kanë deklaruar kuvendin e tyre autonom për t'i mbajtur, siç thonë ata, në kuadër të kushtetutës së Serbisë. Shumë tjerë thonë se ata kanë krijuar kuvendin vetëm sa për të forcuar fuqinë e të bërit pazar në këtë proces. Edhe pse dialogu ka konfirmuar se zgjidhja për veriun varet nga vendimet e bëra nga Prishtina dhe Beogradi, ai poashtu ka treguar se serbët e veriut janë një forcë e cila duhet të merret në konsideratë. Ata nuk kanë fuqi të mjaftueshme për të parandaluar implementimin, por kanë kapacitet të mjaftueshëm për ta ndërprerë dhe për ta vonuar procesin. Shëndrrimi i mosbindjes së tyre në bashkëpunim është thelbësor për implementimin e suksesshëm të marrëveshjes.

Dyshimet dhe rezistenca ndaj marrëveshjes ekzistojnë edhe në mesin e popullatës shqiptare të Kosovës. Shumica e interpretojnë këtë si diçka e cila i jep veriut një status autonom me kapacitet për të minuar shtetin e Kosovës. Shumica e partive politike opozitare kanë ofruar përkrahjen e tyre vetëm pas trysnisë së fuqishme ndërkombëtare.² Disa nga anëtarët e partive politike në qeveri janë poashtu kundër marrëveshjes.³ Pjesa dërrmuese e organizatave të shoqërisë civile e përshkruan dialogun dhe marrëveshjen që doli nga ai dialog si humbje për Kosovën. Mendimi më i pranishëm është se institucionet e tanishme të Serbisë në veri mund të integrohen në institucionet e Kosovës por ato do të mbeten lojale ndaj Beogradit dhe do të vazhdojnë të

¹ Kryetarët e Mitrovicës Veriore dhe Leposaviqit janë nga Partia Progresive Serbe (SNS) dhe kryetarët e Zvecanit dhe Zubin Potokut janë nga Partia Demokratike e Serbisë (DSS), një kundërshtar i fuqishëm i marrëveshjes. Edhe pse kryetarët e SNS-së mund të ndodhë që do t'iu duhet tu binden urdhërave të qeverisë së Serbisë dhe partisë së tyre, kryetarët e DSS-së ka gjasa të provojnë ta minojnë implementimin në komunat e tyre. DSS kanë qenë vazhdimisht kundër dialogut dhe marrëveshjes pasuese.

² Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë votuar në favor të ratifikimit të marrëveshjes. LDK-ja fillimisht e ka kundërshtuar atë dhe madje ka kërkuar edhe mbajtjen e referendumit për atë se a duhet apo jo të dialogohet me Beogradin, por e ka braktisur këtë propozim pas trysnisë së shtuar ndërkombëtare. Anëtarët e Lëvizjes Vetëvendosje (VV) kanë votuar kundër dhe kanë organizuar një protest me qëllimin që marrëveshja të mos ratifikohet.

³ Tre anëtarë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë votuar kundër marrëveshjes. Një numër më i madh beson se marrëveshja nuk është e mirë për Kosovën.

minojnë shtetin e Kosovës nga brenda. Spekulumet se institucionet e reja serbe nuk do të duhet të përdorin simbolet e Kosovës dhe nuk do të duhet të betohen para marrjes së detyrës vetëm sa e forcojnë këtë mendim. Shumë besojnë se pakënaqësia e shqiptarëve të Kosovës do të mund të reduktohej përmes implementimit të marrëveshjes e cila do të rezultonte me përfitime të prekshme.

Kritikët thonë se Prishtina dhe Beogradi kanë bërë pak progres në bindjen e publikut të tyre skeptik për ta përkrahur dialogun dhe marrëveshjen. Kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë janë fokusuar kryesisht në pozicionimin e tyre karshi komunitetit ndërkombëtar, si politikanë pragmatik, të gatshëm për t'u marrë me probleme të vështira, por i kanë neglizhuar bazat e tyre vendore. Shumë thonë se Prishtina dhe Beogradi kanë qenë të njohur për prezentimin kreativ të informatave në lidhje me dialogun. Njerëzit në Kosovë dhe Serbi shohin verzione të ndryshme të marrëveshjes së njejtë. Disa thonë se kjo është për shkak se ata duan ta shohin vetëm gjysmën, shpesh duke i mbivlerësuar disavantazhet dhe duke i nënvlerësuar përfitimet.

Marrëveshja është një skicë me pesëmbëdhjetë pika. Në thelb, marrëveshja bën thirrje për shpërbërjen e institucioneve të Serbisë – administratave lokale, gjykatave, dhe forcës policore – në veri, dhe krijimin e institucioneve të reja përmes zgjedhjeve në përputhje me ligjet e Kosovës. Hapat e parë në drejtim të implementimit veçse janë marrë: Beogradi i ka mbyllur zyret e tij të policisë në veri, dhe Prishtina e ka miratuar ligjin për amnisti.⁴ Përkundër këtij përparimi, Prishtina dhe Beogradi mbeten të matur dhe të kujdesshëm për qëllimet dhe lëvizjet e njëri tjetrit, duke vepruar vetëm pas trysnisë së fuqishme dhe kushtëzimit nga bashkësia ndërkombëtare.

Për ta adresuar rolin e serbëve të veriut në implementimin e marrëveshjes dhe në zgjedhjet e 3 nëntorit, CIG ka organizuar një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues politik dhe të shoqërisë civile nga Kosova e Serbia, si dhe një diskutim të ndarë për përfaqësuesit serbë nga veriu i Kosovës më 21-23 qershor të vitit 2013, në Stamboll të Turqisë.⁵ Ky ka qenë organizimi i gjashtë brenda projektit të CIG mbi veriun e Kosovës. Projekti shërben si një arenë publike në të cilën përfaqësuesit nga Kosova dhe Serbia shkëmbejnë dhe testojnë ide, parime dhe zgjedhje të politikave.

Ky projekt financohet dhe implementohet në bashkëpunim me Departamentin Federal Zvicrran të Punëve të Jashtme dhe ambasadat e Zvicrrës në Prishtinë dhe Beograd.

Nënkryetari i CIG, Shpëtim Gashi, e ka përgatitur këtë raport dhe CIG merr përsipër përgjegjësinë për përmbajtjen e tij. Për të inkurajuar diskutime të hapura, CIG nuk u referohet

⁴ Ligji i amnistisë ka nxitur kundërshti të mëdha në Kosovë, kryesisht për faktin se ligji përfshin jo vetëm aktivitetin ilegal ekonomik e politik në veri, por në të gjithë Kosovën. Ata të cilët e kanë kundërshtuar atë kanë thënë se ligji duhet të vlejë vetëm për veriun, njejtë sikurse ligji për amnisti i Serbisë për jugun e Serbisë.

⁵ Pjesëmarrësit kanë qenë anëtarë nga partitë politike të Kosovës: PDK, LDK, AAK, Partiva e Pavarur Liberale (SLS), Lista e Bashkuar Serbe (JSL), qeveria dhe presidenca e Kosovës; dhe nga Serbia, Partia Demokratike (DS), Partia Socialiste e Serbisë (SPS), Partia Liberal Demokrate (LDP), qeveria dhe presidenca e Serbisë, si dhe një numër i analistëve nga Serbia dhe Kosova.

individëve specifik. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në tryezë në kapacitetet e tyre personale dhe pikëpamjet e tyre jodomosdoshmërisht pasqyrojnë ato të organizatave të cilat i përfaqësojnë.

Shëndrrimi i kundërshtimit në bashkëpunim

Siç është treguar edhe nga një numër i protestave, një pjesë e madhe e popullatës serbe në veri është kundër integritetit në institucionet e Kosovës. Edhe pse disa preferojnë qasje më pragmatike, një numër i madh kundërshton çkado që është më pak se ndarja. Shumë thonë se është e vështirë të integrohen në një shtet tjetër pas funksionimit për katërmëdhjetë vite si pjesë e Serbisë, dhe pasi që u është thënë nga Beogradi se veriu do të mbetet pjesë e Serbisë. Poashtu duket sikur ritmi dhe shtrirja e dialogut i ka zënë shumë në befasi, duke e bërë kështu të vështirë për ta përshtatjen në rrethanat që po ndryshojnë shumë shpejtë. Një numër i vogël kanë parashikuar se brenda një viti, Prishtina dhe Beogradi do të mund të arrinin një marrëveshje të tillë gjithëpërfshirëse.

Përfaqësuesit e katër komunave paralele janë në vijën e parë të frontit në kundërshtimin e marrëveshjes, edhe pse edhe ata që operojnë me institucionet shërbyese janë po as kundërshtues. Shumë diskutues kanë thënë se shëndrrimi i këtij kundërshtimi në bashkëpunim do të jetë sfidues, por jo i pamundshëm. Institucionet lokale janë nën autoritetin ligjor të Beogradit, si dhe janë të varur financiarisht nga qeveria e Serbisë, dhe së këndejmi, do të duhet t'u binden vendimeve të saj. Qeveria e Serbisë është e qartë sa i përket qëllimeve të saja për të implementuar marrëveshjen të plotë dhe brenda kornizës kohore për të cilën është rënë dakord. Ajo tashmë është pajtuar për datën e zgjedhjeve lokale në Kosovë si dhe ka mbyllur zyrtarisht policisë serbe në veri. Për më shumë, udhëheqësit e lartë të Serbisë thonë se implementimi nuk ka alternativë, duke bërë të ditur se nëse zbatimi i qendrimeve nuk funksionon, ata mund të përdorin forcën për të siguruar zbatimin e marrëveshjes. Shumë pjesëmarrës u kanë bërë thirrje udhëheqësve lokalë në veri që të marrin rol dhe përgjegjësi më të mëdha në këtë proces, në vend se ta "kundërshtojnë të pandalshmen". Zyrtarët serbë thonë se ata janë të gatshëm të transferojnë disa nga fuqitë vendimmarrëse nga Beogradi tek përfaqësuesit e serbëve lokalë, por serbët lokalë e refuzojnë atë për shkak se, sic ka thënë njëri nga pjesëmarrësit, "në kohëra kritike më e lehtë është t'u bindesh urdhërave se sa të marrësh përgjegjësi".

Implementimi mund të ballafaqohet edhe me mosbindje qytetare. Shumë thonë se bindja e popullsisë lokale është më sfiduese se sa marrja e kontrollit mbi institucionet lokale. Një numër pjesëmarrësish kanë propozuar një komunikim më intenziv mes qeverisë së Serbisë, si dhe partive politike të Serbisë, dhe serbëve të veriut; më shumë mesazhe pozitive nga Prishtina; dhe garanca të fuqishme nga komuniteti ndërkombëtar se veriu do ta ruajë autonominë e tij sa i përket punëve lokale. Veçanërisht ministritë e Serbisë të cilat kanë një numër domethënës të të punësuarve në Kosovë duhet të jenë të kyçura në këtë debat. Zyrtarë të lartë të Serbisë kanë bërë disa vizita në veri në përpjekje për të qetësuar popullatën. Ata kanë premtuar vazhdimin e ndihmës financiare të Beogradit dhe ruajtjen e vendeve të punës për shërbyesit civil. Ata të cilët janë të njoftuar nga afër me këto vizita thonë se porosia e përgjithshme e Beogradit drejtuar serbëve të veriut ka qenë se "ju nuk duhet ta përkrahni marrëveshjen, por nuk duhet të ndërmerrni veprime të cilat pengojnë zbatimin e saj". Zyrtarët serbë poashtu janë duke provuar të marrin deri diku nën kontroll debatin publik në veri, i cili deri më tani është dominuar nga një numër i vogël, kundërshtarë të marrëveshjes, si dhe ta shpjegojnë nevojën për kompromis.

Një numër i pjesëmarrësve poashtu kanë qenë të brengosur që disa nga anëtarët e qeverisë së Serbisë, përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes, vazhdojnë ta kundërshtojnë atë. Shumë pjesëmarrës kanë thënë se qeveria e Serbisë duhet ta zgjerojë komunikimin e saj me qëllim të përfshirjes edhe të njerëzve të thjeshtë në veri. Shumë serbë e pranojnë se ardhmëria e shtatë milion njerëzve në Serbi nuk duhet të jetë peng i mosmarrëveshjes rreth veriut, dhe se serbët e Kosovës duhet të jenë të gatshëm të sakrifikojnë disa përfitime personale për interesat nacionale. Disa pjesëmarrës kanë thënë se marrëveshja sjellë përfitime substanciale për popullsinë lokale në veri, sidomos në fushën e sigurisë dhe potencialisht në atë të zhvillimit ekonomik, dhe se ajo do të rrisë bashkëpunimin e institucioneve lokale me komunitetin ndërkombëtar, i cili deri më tani nuk ka pasur bashkëpunim me institucionet paralele.

Serbët e veriut kanë një listë të gjatë të brengave, disa më realiste e disa më pak realiste. Ata janë të brengosur se transformimi i institucioneve lokale do të ndikojë në vendet e tyre të punës, pensione, kujdes shëndetësor dhe arsim. Integrimi në sistemin e Kosovës do të thotë edhe paga më të ulëta. Ata poashtu frigohen se me zvogëlimin e rolit politik të Beogradit do të vie edhe deri te zvogëlimi i ndihmës financiare.⁶ Roli gjithnjë në ngritje i Prishtinës poashtu është brengosës për disa, duke pasur parasysh mungesën e besimit që ata kanë në raport me institucionet e Kosovës. Në mesin e brengave më pak realiste janë edhe supozimet se implementimi do të çojë drejt një eksodusi apo asimilimi të popullsisë serbe.⁷

Në mënyrë që të fitohet mbështetja e serbëve të veriut për implementimin e marrëveshjes, pjesëmarrësit kanë propozuar një numër hapash.

1. Beogradi duhet tu shpjegojë serbëve të veriut se edhe pse interesi nacional ka përparësi në raport me interesat lokale kur një konflikt mes tyre ekziston, ai megjithatë i merr parasysh interesat e serbëve të Kosovës në çdo fazë të dialogut me Prishtinën. Edhe pse serbët e veriut do të duhet të operojnë brenda kornizës ligjore dhe politike të Kosovës, marrëveshja ofron mjaft mjete mbrojtëse që ata të mund t'i drejtojnë punët e tyre, siç janë formimi i asociacionit të komunave, policia autonome lokale, dhe garancat se Forca e Sigurisë së Kosovës dhe njësitet speciale të policisë nuk do të hyjnë në veri pa pëlqimin e këtyre të fundit.
2. Një numër i madh i serbëve në veri mendojnë se marrëveshja sakrifikon interesat e tyre të tashme në këmbim të përfitimeve të pasigurta në të ardhmen. Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të tregojnë se marrëveshja është një kompromis mes një *status quo*-je të paqëndrueshme dhe një ardhmërie të qartë. Kjo do të mund të bëhej përmes implementimit të shpejtë dhe të plotë të marrëveshjes që do të rezultonte në përfitime të prekshme.
3. Faktorët joekonomikë – identiteti, dinjiteti kombëtar, dokumentet e identifikimit, shtetësia – mbesin forca të fuqishme në formimin e opinionëve të serbëve të veriut rreth integritetit të tyre në jetën publike të Kosovës. Ata frigohen se integrimi do të thotë edhe ndërrim të identitetit. Edhe ata të cilët janë në favor të integritetit janë kundër përdorimit të simboleve të

⁶ Pagat në institucionet e Serbisë janë dukshëm më të larta se sa ato në institucionet e Kosovës. Një numër i serbëve të Kosovës kanë kërkuar që pas integritetit në sistemin e Kosovës, dallimi në pagë do të duhet të paguhej nga një palë e tretë. Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar janë kundër kësaj. Zyrtarët e Serbisë poashtu thonë se ata nuk do ta mbulojnë këtë diferencë.

⁷ Disa serbë e barazojnë marrjen e nënshtetësisë dhe dokumenteve të Kosovës me asimilim.

Kosovës dhe kundër dhënies së betimit kur një gjë e tillë kërkohet prej tyre, siç janë rastet në forcat policore dhe në gjyqësor. Edhe pse fokusi i Prishtinës, Beogradit dhe komunitetit ndërkombëtar duhet të mbetet në zhvillimin ekonomik të rajonit, ata duhet ta marrin parasysh ndikimin e këtyre faktorëve joekonomik me rastin e krijimit të politikave.

4. Serbët e veriut kanë të drejtë ta kundërshtojnë marrëveshjen përmes mjeteve jo të dhunshme, siç janë protestat apo peticionet. Megjithatë, nëse individë apo grupe të caktuara përdorin dhunën, autoritetet duhet të veprojnë me vendosshmëri dhe shpejtë për të krijuar një mjedis të sigurtë për të gjithë.
5. Prishtina, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet t'u ofrojnë serbëve të veriut më shumë informata rreth marrëveshjes. Fushata informuese do të duhej të intensifikohej sidomos para zgjedhjeve të 3 nëntorit. Deri më tash, informatat për marrëveshjen kanë qenë interpretative, jo të plota, dhe shpesh nuk janë bërë publike me qëllim. Përvoja na tregon se interpretimet shpesh janë më të fuqishme se faktet.
6. Prishtina, në bashkëpunim me serbët e veriut duhet të fillojë identifikimin e fushave për të cilat nëvojitet më së shumti ndihma financiare, dhe ti përdorë këto fonde të dedikuara për rajonin menjëherë pas zgjedhjeve. Në këtë kontekst, komuniteti ndërkombëtar do të mund të luante një rol të rëndësishëm.

Edhe pse zgjidhja e mosmarrëveshjes së veriut do të varet nga zgjedhja e politikave dhe nga vendimet e marra në Prishtinë e Beograd, serbët në veri kanë kapacitete të mjaftueshme për ta vonuar dhe komplikuar procesin. Së këndejmi, sigurimi i bashkëpunimit nga ana e tyre është kyç për të pasur një proces të qetë të implementimit.

Të votohet apo mos të votohet

Serbët e veriut janë në mëdyshje nëse duhet apo nuk duhet të votojnë në zgjedhjet lokale të Kosovës më 3 nëntor. Pjesëmarrja në votime do ta garantonte përfaqësimin e tyre në institucionet e Kosovës, por poashtu do t'u jepte legjitimitet atyre institucioneve, duke bërë kështu që disa ta barazojnë pjesëmarrjen në zgjedhje me njohjen e pavarrësisë së Kosovës. Në anën tjetër, bojkotimi i zgjedhjeve do të ishte në përputhje me politikën e mosnjohjes, por rrezikon t'i lërë serbët e veriut pa përfaqësues dhe institucione legjitime për katër vitet e ardhshme. Vazhdimi i paralelizmit poashtu mund të jetë i paqëndrueshëm, në veçanti pasi Beogradi t'i ketë ndaluar fondet e tij, siç parashihet në marrëveshje.

Shumë thonë se paralelizmi institucional ka krijuar ndarje të thella në mesin e komunitetit serb, ndarje të cilat kanë penguar partitë politike të serbëve të Kosovës në jug që të garojnë në një listë të përbashkët zgjedhore në zgjedhjet parlamentare të Kosovës të vitit 2010. Edhe pse komuniteti serb është shumë më i vogël se ai shqiptar, i cili kishte garuar në shtatë lista zgjedhore, votuesit serbë është dashur të zgjedhin mes tetë listave. Ndarjet mes serbëve në jug dhe atyre në veri ende mbeten të theksuara.

Shumica e pjesëmarrësve kanë thënë se serbët e veriut duhet të marrin pjesë në zgjedhje siç parashihet me marrëveshje. Shumë thonë se tashmë që edhe vetë Beogradi është duke bashkëpunuar me institucionet e Kosovës, bojkotimi i po të njejtave institucione nga serbët e veriut është jopraktik dhe joefikas; ata thonë se bojkoti dhe paralelizmi e kanë pasur kohën e tyre. Është e sigurtë se qendrat e votimit kësaj here do të hapen, por nuk dihet nëse një numër i

konsiderueshëm i serbëve do të dalin për të votuar. Shumë thonë se një grup i njerëzve të fuqishëm lokal nuk do të marrin pjesë dhe mund të organizojnë fushata me qëllim të frikësimit të popullatës, por vetëm një numër i vogël presin që bojkoti të jetë masovik. Edhe pse vetëm një dalje e vogël në zgjedhje do të ishte e mjaftueshme për të krijuar institucione legjitime, disa pjesëmarrës kanë thënë se kjo nuk do t'u mundësonte përfaqësuesve serbë të pretendojnë legjitimitet të gjërë në komunitetin e tyre.⁸

Regjistrimi i partive politike mbetet një tjetër çështje e diskutueshme. Serbët preferojnë ti shmangen regjistrimit në Kosovë, ndërsa autoritetet e Kosovës thonë se regjistrimi është i obligueshëm. Të gjitha partitë ekzistuese politike serbe janë nga jugu, dhe asnjë nga to nuk kanë degë në veri. Partitë politike të cilat synojnë të marrin pjesë në zgjedhjet e 3 nëntorit duhet t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre për çertifikim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës. Degët në Kosovë të partive të Serbisë nuk do të mund të marrin pjesë në zgjedhje pa u regjistruar në Kosovë. Pjesëmarrësit kanë thënë se dy kryeministrit duhet ta zgjidhin këtë problem dhe i kanë bërë thirrje OSBE-së që ta lehtësojë procesin. Sipas atyre që janë të afërt me dialogun, partitë do të duhet t'i dorëzojnë dokumentet në OSBE, e cila pastaj do t'i dërgonte ato tek autoritetet e Kosovës. Deri më tash, asnjë parti e re nuk ka dorëzuar aplikacionet e regjistrimit.

Votimi jashtë Kosovës është një tjetër sfidë. Marrëveshja u lejon serbëve të Kosovës të cilët jetojnë në Serbi të votojnë atje. Organizimi i qendrave të votimit, vetë votimi dhe numërimi i votave mund të jetë proces i komplikuar, duke pasur parasysh se serbët e Kosovës në Serbi janë të shpërndarë në gjithë vendin. Beogradi do të ketë një rol kyç në këtë aspekt. Disa kanë ngritur çështjen e votimit për shqiptarët e zhvendosur nga komunat veriore dhe i kanë bërë thirrje Prishtinës dhe komunitetit ndërkombëtar të krijojnë kushte që edhe ata të mund të votojnë.

Pjesëmarrësit serbë kërkojnë që serbët e Kosovës të lejohen të votojnë dhe të garojnë në zgjedhje me dokumente të Serbisë. Ligji zgjedhor i Kosovës është duke u interpretuar në mënyra të ndryshme. Edhe pse ligji specifikon se njerëzit mund të votojnë me dokumente të identifikimit të Kosovës, zyrtarët e Kosovës pranojnë se do të ketë fleksibilitet për serbët. Sipas disa raporteve të ndryshme, kryeministrit tashmë janë pajtuar që serbëve t'u lejohet përdorimi i dokumenteve të Serbisë në gjithçka që lidhet me zgjedhjet.

Për të siguruar pjesëmarrje solide dhe proces të rregullt zgjedhor, pjesëmarrësit kanë dalë me një numër përfundimesh dhe rekomandimesh.

1. Partitë politike të serbëve të Kosovës duhet të vendosin një bashkëpunim më të gjërë, t'i harmonizojnë politikat e tyre, t'i koordinojnë aktivitetet, dhe të veprojnë si një aleancë fleksibile politike – jodomosdoshmërisht të garojnë në një listë të përbashkët – në zgjedhjet lokale të 3 nëntorit. Veprimet e koordinuara do të promovojnë kohezion politik e social dhe do të forcojnë fuqinë e të bërit pazar të komunitetit serb në politikën e Kosovës. Në mënyrë që zgjedhjet të jenë të lira dhe të ndershme, dhe në mënyrë që institucionet që dalin nga këto

⁸ Vetëm rreth një përqind e serbëve të Kosovës ka votuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 në Kosovë, por përfaqësuesit e zgjedhur serbë kanë marrë detyrat dhe janë konsideruar legjitim nga Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar. Megjithatë, ata të cilët janë zgjedhur kanë thënë se nuk kanë qenë në gjendje të pretendojnë legjitimitet të gjërë në mesin e popullatës serbe, dhe sic thonë edhe ata vetë, kanë qenë "legal por jo legjitim".

zgjedhje të mund të pretendojnë legjitimitet të gjërë, duhet të krijohen kushtet që të gjitha partitë serbe të operojnë të papenguara në tërë territorin e Kosovës (p.sh. Partia e Pavarrur Liberale dhe Lista e Bashkuar Serbe në veri). Përgjegjësia për të krijuar një mjedis të tillë bie kryesisht mbi Beogradin dhe komunitetin ndërkombëtar. Shumica pajtohen se Prishtina ka pak ose aspak ndikim në veri.

2. Udhëheqësit lokal në veri duhet të përfshihen menjëherë dhe të marrin përgjegjësi për organizimin e zgjedhjeve dhe implementimin e aspekteve të tjera të marrëveshjes. Ata poashtu duhet të bëhen anëtarë të ekipeve përgatitore, përgjegjëse për tranzicionin institucional. Ekziston konsensusi për atë se nëse udhëheqësit lokal nuk do ta përkrahnin implementimin, ata së paku nuk duhet të ndërmarrin veprime për ta minuar atë.
3. Lista e votuesve e Serbisë do të përdoret në zgjedhjet në veri. Megjithatë, kjo listë duhet të pastrohet me qëllim të menjanim të manipulimeve. Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të bashkëpunojnë ngushtë për t'u ofruar mundësinë sa më shumë që është e mundur serbëve të Kosovoës në Serbi të votojnë. Shqiptarëve të zhvendosur nga veriu poashtu duhet t'u ofrohet mundësia për të votuar dhe për të marrë pjesë në administratën e re. OSBE-ja dhe organizatat tjera ndërkombëtare duhet ta lehtësojnë procesin.
4. Beogradi duhet t'i adresojë brengat e punëtorëve të institucioneve inekzistente të Serbisë – të cilat në fakt kanë pushuar së funksionuari pas largimit të administratës së Serbisë në vitin 1999. Beogradi mund të mos jetë në gjendje të vazhdojë t'i bëjë këto pagesa përgjithmonë, por ai do të duhej të ofronte një lloj asistence gjatë procesit të tranzicionit.
5. Siguria duhet të përmirësohet thelbësisht gjatë fushatës elektorale dhe në ditën e votimit. Policia e Kosovës, KFOR-i dhe EULEX-i do të duhej të ishin institucionet e vetme që ofrojnë siguri. Institucionet tjera të sigurisë duhet të shpërbëhen para se të fillojë fushata dhe grupe të caktuara duhet të parandalohen nga frikësimi i votuesve dhe atyre që garojnë në zgjedhje.

Këto zgjedhje janë posaçërisht të rëndësishme sepse zyrtarët e zgjedhur do të jenë përgjegjës për formimin e asociacionit të komunave, institucion ky gjithpërfshirës për komunat me shumicë serbe. Një numër i përfaqësuesve serbë kanë propozuar që serbët të garojnë në një listë të përbashkët, edhe pse pak prej tyre mendojnë se kjo është e mundur duke pasur parasysh ndarjet ekzistuese përbrenda komunitetit serb. Gara në shumë lista do ta komplikojë procesin e krijimit të shumicës në asamblatë komunale dhe ndërtimin e institucioneve funksionale. Megjithatë, disa kanë thënë se është më mirë të jenë dy apo tri lista, pasi që një gjë e tillë ofron më shumë zgjedhje për votuesit dhe do të mund të ndihmonte në demokratizimin e komunitetit serb në Kosovë. Ka ekzistuar pothuajse konsensus në takim se Beogradi do të mund të luante rol unifikues dhe të ndihmonte në ngushtimin largësisë mes entiteteve ekzistuese politike.

Përfundim

Ajo që as nuk mund të paramendohej tashmë është bërë e paevitueshme. Pak njerëz kanë mundur të parashikojnë që vetëm pesë vite pas shpalljes së pavarrësisë, kur Prishtina dhe Beogradi i rënduan edhe më tej marrëdhëniet, anëtarë të policisë së Serbisë që operojnë në veri të Kosovës dhe anëtarë të policisë së Kosovës do të duhet të punojnë së bashku në një institucion të përbashkët. Shumë thonë se ritmi dhe shtrirja e negociatave mes kryeministrave të Kosovës e Serbisë, dy armiqë të përbetuar, i ka befasuar.

Pjesëmarrësit kanë identifikuar përkrahjen e serbëve të veriut për marrëveshjen dhe zgjedhjet e 3 nëntorit në veri si dy çështjet më të rëndësishme në kuadër të integritetit të rajonit në institucionet e Kosovës. Përfundimi i përgjithshëm ka qenë se përfshirja e serbëve të veriut në procesin e implementimit është e dëshirueshme, por jo e domosdoshme. Një numër hapash – siç janë, mbyllja e zyreve të policisë së Serbisë – tashmë janë implementuar pa ndonjë rezistencë serioze nga ana e serbëve. Shumica presin që kjo rezistencë të zbehet edhe më tej me fillimin e implementimit. Megjithatë, përfshirja e serbëve të veriut është kyçe për ndërtimin e institucioneve funksionale dhe për krijimin e një mjedisi të sigurtë pas zgjedhjeve.

Zgjedhjet në veri do të jenë zgjedhjet e para atje të organizuara sipas ligjeve të Kosovës, qysh nga shpallja e pavarrësisë. Prishtina dhe Beogradi janë ende në proces të finalizimit të detajeve – lista e votuesve, letërnjoftimet, regjistrimi i partive, votimi jashtë Kosovës, përdorimi i simboleve të Kosovës – por ata janë pajtuar që 3 nëntori të jetë dita e zgjedhjeve. Përkundër datës, serbët në veri ende janë në dilemë nëse duhet të marrin pjesë në zgjedhje apo jo. Shumica e pjesëmarrësve i kanë inkurajuar serbët në veri që të marrin pjesë në zgjedhje dhe të marrin mbi vete përgjegjësi për të ardhmen e tyre.

Shumë pjesëmarrës kanë thënë se pjesëmarrja e serbëve të veriut në zgjedhje dhe integrimi në institucionet e Kosovës që do të pasojë, do të ishte e dobishme për të gjitha palët – serbët e Kosovës, Prishtinën dhe Beogradin. Kjo pjesëmarrje do ta institucionalizonte mbrojtjen e interesave të komunitetit serb në Kosovë dhe do ta zvogëlonte izolimin dhe varshmërinë e tyre; pjesëmarrja do t'i akomodonte pritjet e autoriteteve të Kosovës për integrimin e serbëve; dhe ajo do ta lironte Beogradin nga obligimet e tanishme të menaxhimit dhe financimit të politikës lokale në një territor i cili është jashtë kontrollit të tij.

Pjesëmarrësit

Sipas alfabetit të gjuhës angleze

Illir Deda, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Sadri Ferati, Lidhja Demokratike e Kosovës
Ardian Gjini, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Dukagjin Gorani, Analist politik
Adrijana Hodzic, Qeveria e Kosovës
Oliver Ivanovic, Iniciativa Qytetare “Serbi, Demokraci, Drejtësi”
Marko Jaksic, Avokat, Mitrovicë
Dusan Janjic, Sociolog
Jadranka Joksimovic, Partia Progresive Serbe
Gezim Kasapolli, Qeveria e Kosovës
Dusan Kozarev, Zyra e Presidentit të Serbisë
Leon Malazogu, Instituti Demokraci për Zhvillim
Milivoje Mihajlovic, Qeveria e Serbisë
Ljubisa Mijacic, Zubin Potok
Petar Miletic, Partia e Pavarrur Liberale
Smiljka Milisavljevic, Universiteti në Mitrovicë
Randjel Nojkic, Lëvizja e Ripërtritjes Serbe
Zoran Ostojic, Partia Liberal Demokrate
Dejan Radenkovic, Partia Socialiste e Serbisë
Nenad Radosavljevic, Rrjeti i TV stacioneve serbe në Kosovë
Behar Selimi, Partia Demokratike e Kosovës
Predrag Simic, Universiteti i Beogradit
Jelena Trivan, Partia Demokratike
Arber Vllahu, Zyra e Presidentes së Kosovës
Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Jeffrey Giauque, Departamenti Amerikan i Shtetit
Alex Grigorev, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Krystyna Marty, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës
Igor Novakovic, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Jean-Daniel Ruch, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës
Norbert Ruetsche, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës
Talia Wohl, Departamenti Federal për Punë të Jashtme i Zvicrrës